




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. 1 faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr Prot. Br Prot. Prot No	01-1119/14
Data Datum Date	24.03.2014
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	24/03/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Zelfije KELMENDI Zyrtare e Prokurimit – Spitali Rajonal - Pejë
CC:	z. Skender DRESHAJ Drejtor - Spitali Rajonal - Pejë
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: “Furnizim me pajisje Mjekësore”



E nderuar z. KELMENDI

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: “Furnizim me pajisje Mjekësore” me nr. të prokurimit: 70500-14-010-111, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me “Furnizim me pajisje Mjekësore” me nr. të prokurimit: 70500-14-010-111, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Spitali Rajonal-Pejë ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Furnizim me pajisje Mjekësore” me nr. të prokurimit: 70500-14-010-111, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë: 11/03/2014, në Procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë monitorimit të këtij aktiviteti të prokurimit, Agjencia ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e Prokurimit publik në Kosovë.

Në Njoftim për Kontratë, pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar Dëshmia e kërkuar dokumentare, pa u vënë paraprakisht kriteret si kërkesë për përshtatshmërinë profesionale. Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare, kërkohet: Certifikatë ose dëshmi me të cilën vërtetohet se Pajisjet e ofruara të jenë të prodhuara ose të regjistruara për qarkullim dhe shitje në shtetet e BE-së, SHBA, Kanada, Australi, Zvicër, Izrael, Japoni. Autoriteti Kontraktues ka paracaktuar origjinën e produktit. Me paracaktimin e vendit të origjinës për produktet furnizuese, Autoriteti Kontraktues favorizon Operator të caktuar Ekonomik dhe në të njëjtën kohë diskriminon të tjerët. Autoriteti Kontraktues mund ti referohet një standardi vendor ose ndërkombëtar për furnizim me produkte, por assesi të kërkohet nga ndonjë vend i caktuar. Bazuar në legjislacionin e vendit dhe ligjeve në fuqi, një gjë e tillë nuk është e lejuar dhe nuk i jep hapësirë konkurrencës së lirë dhe legale.

Gjithashtu tek e njëjta rubrikë është kërkuar: Deklarata e ofertuesit për Servisim të autorizuar dhe mirëmbajtje gjatë kohës së garancionit dhe jashtë saj, si dhe Dëshmi për mbulim me pjesë rezervë për një kohë të gjatë. Terminologjia e përdorur “...mirëmbajtje gjatë kohës së garancionit dhe jashtë saj” si dhe “...pjesë rezervë për një kohë të gjatë” duhet të specifikohet në detaje minimumi i periudhës së garancionit si dhe minimumi për sa kohë pas furnizimit duhet të jetë i pajisur tregu me pjesë rezervë për produktin e caktuar.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; nenin 27 Dosja e Tenderit; dhe, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !